

Varrimi përfundimtar i mbetjeve mortore të Hasanit u bë më 11.08.2000 në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata Xh. K, FDH-36847; deklarata R.K, FDH-11174; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 125, FDH-23857; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00701, FDH-35931.

Adem (Ymer) Buzhala

(6.01.1951, shqiptar nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor në fabrikën Ballkan, katër fëmijë)

Ademi ka marr pjesë në mbrojtjen e fshatit [**Budakovë/Budakovo**] më **27.09.1998**, kur forcat serbe kanë hyrë në fshat. Ka pësuar gjatë betejës. Trupin e tij të pajetë e kanë gjetur dy banorë më 29.09.1998 dhe, në të njëjtën ditë, e kanë varrosur në varrezat e *Mëhallës Buzhala* [Budakovë/Budakovo], ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata B.B, FDH-36846; deklarata A.K, FDH-11167; deklarata N.N, FDH-3656; deklarata N.N, FDH-3655; deklarata N.N, FDH-3654; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; fotografi, FDH-36137; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00701, FDH-35931.

Bafti (Zeqir) Bajraktari

(3.07.1915, shqiptar nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, një fëmijë)

Gjatë ofensivës së forcave serbe më 27.09.1998, për Baftiun e moshëthyer u kujdeseshin të afërmit e tij. Me ta u arratis në bjeshkën përmbi fshatin e **Budakovës/Budakovo**. Përveç Baftiut, kushëririt Ramadanit dhe disa banorëve të moshuar, të gjithë banorët u tërhoqën në thellësi të malit, ndërkaq ata e kaluan natën në livadhin e Liman Halitit. Në mëngjes, më **28.09.1998**, kur Ramadani u zgjua nga gjumi, Baftiu nuk ishte pranë tij. Pas disa ditësh, Ramadani dhe banorë të tjerë kanë dëgjuar në lajmet se Baftiun e kishin plagosur dhe se pjesëtarë të forcave serbe e kanë çuar në spitalin e Prizrenit/Prizren, ku ndërroi jetë më 3.10.1998. Nipërit e Baftiut, Muhameti dhe Salihu,

e kanë marr trupin e Baftiut dhe e kanë varrosur në varrezat e Shirokës/Široko. Pas përfundimit të luftës, pjesëtarë të KFOR-it i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Baftiut dhe i kanë çuar në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac. Pas obduksionit, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Baftiut në varrezat e Budakovës/Budakovo.

Burimet: deklarata S.H, FDH-36844; deklarata R.B, FDH-11166; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, IX, 184; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 121, FDH-23857; USCG KGDH, *Registri..*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički..*, III, 229, 914; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00701, FDH-35931.

Burim (Hamdi) Elshani

(27.08.1977, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, montues dyersh, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Hazir (Rrustem) Bajraktari

(31.05.1958, shqiptar nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, pesë fëmijë)

Burimi u inkuadrua në UÇK në muajin korrik të vitit 1998. Ka qenë i pozicionuar në pozicionet në fshatin Vraniq/Vranić. E kanë plagosur më 27.09.1998, kur forcat serbe e bombarduan fshatin. Hazirin e kanë plagosur dy ditë më herët, kur forcat serbe e bombarduan Budakovën/Budakovo. Ndihmën e parë e ka marr në spitalin në *Lagjen Buzhalë*. Me familje u strehuan në Vraniq/Vranić, ndërkaq, më 27.09.1998, me banorët e fshatit, refugjatët nga fshatrat përreth dhe pjesëtarët e UÇK-së kaluan në luginën e *Rrekës së Vraniqit/Vranićka reka* [**Vraniq/Vranić**]. Më **28.09.1998**, forcat serbe e zbuluan vendstrehimin e refugjatëve. I kanë ndarë burrat të aftë për ushtri dhe të plagosurit, në mesin e tyre edhe Hazirin dhe Burimin. Burrave të ndarë u urdhëruan që të deshën deri në shokë. I morën në pyetje për UÇK-në. Më atë rast, policët serb i kanë vrarë Hazirin dhe Burimin. Rreth 140 burra u bartën me kamiona në Prizren. Pas dy ditësh, banorë të Vraniqit/Vranić i kanë gjetur trupat e Burimit